



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.452/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.10.2017 mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me numër ZL.Anr.452/2017 e datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i më datën 23.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se në vendvotimin nr.0441D/01R, asaj ju kanë mohuar 30 vota, pasi që ajo thekson se ka marrur 55 vota, ndërsa në listën e KQZ-së, i janë shënuar vetëm 25. Më tej ka shtuar se kryesuesi i vendvotimit në fjal dhe komisionerët kanë deklaruar se ajo ka pasur 55 vota dhe se nuk edin si ka ndodhur që ju kanë shënuar vetëm 25.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimin 0441D/01R, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankueses Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

ZLAnr.452/2017 me datën 24.10.2017.



Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.